



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 701, datë 24.11.2017

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushën e diasporës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

PANDELI MAJKO

MARRËVESHJE
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR
BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN
E DIASPORËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (këtej e tutje referuar si "Palë"),

Me dëshirën për të zhvilluar dhe forcuar më tej marrëveshjet dypalëshe ekzistuese mes dy vendeve, në fushën e diasporës.

Të inkurajuar nga vullneti i përbashkët për të promovuar bashkëpunimin mes vendeve të tyre në fushën e diasporës për: ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e identitetit kombëtar, kulturor, gjuhësor dhe arsimor; përmirësimin e gjendjes së tyre sociale në vendet pritëse; realizimin e të drejtave të tyre politike në Atdhe; si dhe përfshirjen e tyre në zhvillimet ekonomike dhe sociale të tij;

Të bindur që bashkëpunimi i tyre në fushën e diasporës është një instrument me vlera dhe përfitime për të dy shtetet, si edhe për diasporën shqiptare në botë:

Kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Palët do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunim në fushën e diasporës mes dy vendeve mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok.

Ky bashkëpunim do të përfshijë:

1. Fushën e mësimin të gjuhës shqipe për fëmijët e mërgatës shqiptare; mbështetjen e aktiviteteve dhe projekteve kulturore-artistike për promovimin e kulturës shqiptare dhe forcimin e identitetit kombëtar në vendet pritëse por edhe të origjinës;
2. Lidhjen e marrëveshjeve të reja të njohjes së kontributeve shoqërore dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre themelore;
3. Identifikimin dhe hartografimin e mërgatës shqiptare, me qëllim realizimin e të drejtës së tyre për të votuar nga vendet ku jetojnë për zgjedhjet parlamentare dhe lokale në Atdhe;
4. Realizimin e projekteve dhe iniciativave të cilat synojnë përfshirjen aktive të mërgatës shqiptare në zhvillimin ekonomik dhe social të Atdheut.

Neni 2

Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe programeve në fushën e diasporës.

Neni 3

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin direkt në mes institucioneve përgjegjëse të diasporës të vendeve, e cila do të realizohet përmes shkëmbimit të vizitave të drejtuesve dhe ekspertëve në fushat e përmendura, si dhe përmes konferencave apo aktiviteteve të përbashkëta.

Palët bien dakord që të caktojnë pika kontakti, në këtë drejtim.

Neni 4

Sipas mundësive, Palët bien dakord që të punojnë së bashku me një plan të përbashkët veprimi në fushën e diasporës.

Neni 5

Palët angazhohen të ngrenë qendra të përbashkëta kulturore për diasporën kudo që do të vlerësojnë se është e nevojshme për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit shqiptar.

Neni 6

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin direkt të institucioneve përgjegjëse që përfshijnë koordinimin për arsimimin, regjistrimin, organizimin dhe mbrojtjen e përbashkët e të drejtave të të gjithë shqiptarëve të cilët janë larguar nga vendi i tyre.

Neni 7

Palët do të mbështesin bashkëpunimin e institucioneve të tyre brenda kornizës së parimeve të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës Botërore të Migracionit.

Neni 8

Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e palëve ,që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare të cilat janë detyruese për palët.

Neni 9

Kjo marrëveshje nuk përjashton mundësinë për forma të tjera bashkëpunimi, të cilat nuk janë specifikuar në të por janë në përputhje me objektivat e saj.

